
LARTI SH.P.K
PASQYRAT FINANCIARE MË DHE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2022

NUIS: J94316024A

Adresa: BULGAREC KORÇË

PËRMBAJTJA

| | FAQE |
|--|-------------|
| RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR | |
| PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR | 1-2 |
| PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHPËRFSHIRËSE | 3 |
| PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL | 4 |
| PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE | 4-5 |
| SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE | 5-26 |

Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2021

| | Shënime | <u>31 dhjetor 2022</u> | <u>31 dhjetor 2021</u> |
|---|---------|-----------------------------|-----------------------------|
| AKTIVE | | | |
| Aktivët afatgjatë | | | |
| Aktivët afatgjatë materiale | 6 | 660,607,957 | 674,439,725 |
| Aktivët afatgjatë jomateriale | 7 | | |
| Aktive në përdorim | 8 | | |
| Llogari të arkëtueshme të tjera | 9 | | |
| Shpenzime të shtyra | 10 | | |
| <u>Pjesëmarrje në njësi të kontrolluara</u> | 11 | | |
| Totali i aktiveve afatgjatë | | 660,607,957 | 0 674,439,725 |
| Aktivët afatshkurtra | | | |
| Inventarë | 12 | 618,947,348 | 776,520,126 |
| Llogari të arkëtueshme tregtare | 13 | 1,520,653,346 | 883,699,144 |
| Llogari të arkëtueshme të tjera | 14 | | |
| Tatim mbi fitimin i parapaguar | 36 | | |
| Aktive të tjera financiare afatshkurter | 35 | 3,916,664 | 1,725,087 |
| Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra | 15 | | |
| Mjete monetare në arkë e në bankë | 16 | 235,484,329 | 562,423,545 |
| <i>Aktive të tjera (shpenzime të shtyra dhe parapagime)</i> | 16 | 430,305,877 | 273,562,524 |
| Totali i aktiveve afatshkurtra | | <u>2,809,307,564</u> | <u>2,497,930,426</u> |
| Totali i aktiveve | | <u>3,469,915,521</u> | <u>3,172,370,151</u> |
| KAPITALI | | | |
| Kapitali aksionar | | 960,000,000 | 960,000,000 |
| Rezerva ligjore | | 94,415,664 | 94,415,664 |
| Rezerva të tjera | | | |
| Fitime të mbartura | | 976,541,624 | 682,443,401 |
| <u>Fitimi/(humbja) e vitit</u> | | 325,035,703 | 314,098,223 |
| Totali i kapitalit | 17 | <u>2,355,992,991</u> | <u>2,050,957,288</u> |
| DETYRIMET | | | |
| Detyrime afatgjatë | | | |
| Hua afatgjatë | 18 | 48,319,290 | 244,458,432 |
| <u>Detyrime për qira afatgjatë</u> | 20 | | |
| Totali i detyrimeve afatgjatë | | 48,319,290 | 244,458,432 |
| Detyrime afatshkurtra | | | |
| Hua afatshkurtra | 18 | 57,097,354 | 60,334,147 |
| Obligacione | 19 | - | - |
| Detyrime financiare të tjera | 20 | 3,477,676 | 3,418,789 |
| Llogari të pagueshme tregtare | 21 | 641,513,421 | 381,201,321 |

LARTI sh.p.k**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022**

(Vlerat janë në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

| | | | |
|--|----|-----------------------------|-----------------------------|
| Detyrime tatimore | 22 | 15,778,187 | 6,074,409 |
| Parapagimet e arkëtuara | 23 | | |
| Grante, të ardhura të shtyra e të tjera detyrime | 24 | 225,640,628 | 313,753,211 |
| <u>Llogari të pagueshme të tjera</u> | 25 | <u>122,095,974</u> | <u>112,172,554</u> |
| <u>Totali i detyrimeve afatshkurtra</u> | | <u>1,065,603,240</u> | <u>876,954,431</u> |
| <u>Totali i detyrimeve</u> | | <u>1,113,922,530</u> | <u>1,121,412,863</u> |
| <u>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</u> | | <u>3,469,915,521</u> | <u>3,172,370,151</u> |

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 5 - 26, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe Të Ardhurave të tjera gjithpërfshirëse
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022**

| Shënime | | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 |
|---|----|---|---|
| Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit | 26 | 6,154,879,019 | 6,339,076,848 |
| <u>Të ardhura të tjera</u> | 27 | | |
| Total të ardhura | | 6,154,879,019 | 6,339,076,848 |
| Materiale dhe shërbime direkte | 28 | -5,529,341,432 | -5,778,506,495 |
| Shpenzime personeli | 29 | -38,133,894 | -37,784,648 |
| Shpenzime amortizimi | 30 | -15,612,670 | -12,775,406 |
| Shpenzime zhvleresimi | 31 | - | - |
| <u>Shpenzime të tjera të shfrytëzimit</u> | 32 | -127,315,634 | -119,950,869 |
| Total shpenzime | | -5,710,403,630 | -5,949,017,418 |
| Shpenzime interesi dhe të ngjashme (neto) | 33 | -61,853,686 | -20,150,810 |
| <u>Shpenzime të tjera financiare (neto)</u> | 34 | | |
| <u>Fitimi/humbja para tatimit</u> | | 382,621,703 | 369,908,620 |
| <u>Shpenzimi i tatimit mbi fitimin</u> | 35 | -57,586,000 | -55,810,397 |
| Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin | | -57,586,000 | -55,810,397 |
| <u>Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë</u> | | - | - |
| <u>Fitimi/(humbja) e vitit</u> | | 325,035,703 | 314,098,223 |
| <u>Shpenzime të tjera gjithpërfshirëse për vitin</u> | | | |
| Totali i shpenzimeve të tjera gjithpërfshirëse për <u>vitin</u> | | <u>0</u> | <u>0</u> |
| Totali i (shpenzimeve)/të ardhurave <u>gjithpërfshirëse për vitin</u> | | <u>325,035,703</u> | <u>314,098,223</u> |

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 5 - 26, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare më 31 dhjetor 2022

| | Periudha Raportuese | Periudha Para ardhese |
|--|--------------------------------|----------------------------------|
| Fluksi mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit: | | |
| <i>Te arketuara nga te drejtat e arketueshme</i> | 5,515,733,240 | 6,599,174,873 |
| <i>Te paguara per detyrimet e pagueshme dhe detyrime ndaj punonjesve</i> | (5,511,999,353) | (5,932,741,667) |
| <i>Pershkruaj</i> | | |
| <i>Pershkruaj</i> | | |
| <i>Pershkruaj</i> | | |
| <i>Pershkruaj</i> | | |
| Mjete monetare te gjeneruara nga aktiviteti i shfrytezimit | | |
| Interes i paguar | (61,853,686) | (20,150,810) |
| Tatim fitimi i paguar | (57,586,000) | (55,841,986) |
| Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit | (115,705,799) | 590,440,410 |
| Fluksi i mjeteve monetare nga/ perdorur ne aktivitetin e investimit | | |
| <i>Pagesa per blerjen e aktiveve afatgjata</i> | (1,780,902) | (9,054,286) |
| <i>Pershkruaj</i> | | |
| <i>Pershkruaj</i> | | |
| <i>Pershkruaj</i> | | |
| Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e investimit | (1,780,902) | (9,054,286) |
| Fluksi i mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e financimit | | |
| <i>Pershkruaj</i> | | |
| <i>Hua te arketuara</i> | 9,923,420 | 60,584,030 |
| <i>Pagesa e huave</i> | (199,375,935) | |
| <i>Dividente te paguar</i> | (20,000,000) | (80,000,000) |
| <i>Pershkruaj</i> | | (33,193,465) |
| Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e financimit | (209,452,515) | (52,609,435) |

| | | |
|---|----------------------|--------------------|
| Rritje/(renie) neto ne mjetet monetare dhe ekuivalente me to | (326,939,216) | 528,776,689 |
| Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fillim | 562,423,545 | 33,646,856 |
| Efekti i luhatjeve te kurset te kembimit te mjetet monetare | | |
| Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fund | 235,484,329 | 562,423,545 |

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 5 - 26, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

LARTI sh.p.k(“Shoqëria”) u themelua si Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar më 29.09.1999 dhe u regjistrua në Regjistrin Tregtar me Vendimin Nr. 22042, datë 22.09.1999, të Gjykatës së Rrethit Tiranë.

Shoqëria është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe në Drejtorinë Rajonale të Tatim Paguesve të Mëdhenj Tiranë me NIPT J94316024A.

Kapitali i Shoqërisë është 960,000,000 Lekë, i ndarë në 1,000 aksione me vlerë nominale 960,000 Lekë secili. 100% e kuotave të kapitalit të saj zotërohen në kuota të barabarta nga 2 ortakët themelues, dhe konkretisht z. Luan Larti i cili zotëron 50% të kapitalit dhe Z. Astrit Isa i cili zotëron 50% të kapitalit të shoqërisë. Te dy ortakët janë njëkohësisht edhe Administratore të saj

Shoqëria LARTI, fillim lindi si një sipërmarrje e vogël e cila tregëtonte materiale ndërtimi në Korçë dhe rrethina perreth. Fale punëskembëngulësve të themeluesve të saj, dhe çelësive të lartë të mallrave që tregëtonte, aktiviteti rritej vazhdimisht dhe mallrat zune një vend të rëndësishëm në treg. Klientela filloi të shpërndahej në pothuajse të gjithë territorin Shqiptar.

Objekti i aktivitetit ka ardhur duke u zmadhuar, përveç tregëtisë së materialeve të ndërtimit, në bëjme edhe grumbullim skrapit hekuri, dhe vitet e fundit jemi fuqishëm në treg edhe si kompani ndërtimi e objekteve të banimit dhe tregëtimit, si dhe rikonstruksione të ndërtimit. Shoqëria gjithashtu ofron edhe shërbimin e transportit të mallrave për të treta.

Tashmë shoqëria Larti shpk, përveç dy adresave kryesore të tregëtimit, ka disa adresa sekondare ndërtimi dhe tregëtimi të objekteve.

2. Bazat e përgatitjes

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare të LARTI sh.p.k janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

Detajet e politikave kontabël të Shoqërisë, duke përfshirë edhe ndryshimet gjatë vitit, janë të përfshira në Shënimin 4.

2.2. Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike. Informacion kontabël përpunohet në software "SAP".

Këto Pasqyra Financiare janë të paraqitura më dhe për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022.

Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar dhe se do të jetë në gjendje të shfrytëzojë aktivitetet e saj dhe shlyejë detyrimet e saj gjatë rrjedhës normale të biznesit.

2.3. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

3. Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara

3.1. Standardet dhe interpretimet e reja efektive në periudhën aktuale

Standardet e amenduara më poshtë janë bërë efektive për kompaninë nga 1 janar 2021, por nuk kanë pasur asnjë impakt material në kompani:

- Konçensione të lidhura me qiratë në kushtet e COVID-19 përtej 30 qershor 2021 (Ndryshime në SNRF 16)
- Reforma e Referencës së Normës së Interesit (Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7) Faza 2

4. Politika Kontabël të rëndësishme

Shoqëria ka aplikuar në mënyrë të qëndrueshme politikat e mëposhtme kontabël për të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare:

4.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zërat monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 është detajuar si më poshtë:

| Kursi i këmbimit | 31 dhjetor 2022 | 31 dhjetor 2021 |
|-------------------------|------------------------|------------------------|
| EUR/LEK | 114.23 | 120.76 |
| USD/LEK | 107.05 | 106.54 |

4.2. Instrumentat financiare

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit.

Instrumentat financiare – njohja fillestare. Instrumentet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDNFH) fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë. Të gjithë instrumentet e tjerë financiarë fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare përcaktohet më së miri nga çmimi i transaksionit. Pas njohjes fillestare, një humbje e pritshme e kredisë (HPK) njihet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar (KA) dhe investimet në instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ), duke rezultuar në një humbje kontabël të menjëhershme.

Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – kategoritë e matjes. Kompania klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme të matjes: VDNFH, VDATGJ dhe KA. Klasifikimi dhe matja pasuese e aktiveve financiare të borxhit varet nga: (i) modeli i biznesit i kompanisë për menaxhimin e portofolit të aktiveve të lidhura dhe (ii) karakteristikat e fluksit të mjeteve monetare të aktivit.

Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – modeli i biznesit. Modeli i biznesit pasqyron mënyrën se si Kompania menaxhon pasuritë në mënyrë që të gjenerojë flukse monetare - nëse objektivi i Kompanisë është: (i) vetëm për të mbledhur flukse monetare kontraktuale nga aktivet ("mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale") ose (ii) për të mbledhur të dyja fluksin e mjeteve monetare kontraktuale dhe fluksin e mjeteve monetare që rrjedhin nga shitja e aktiveve ("duke arkëtuar flukse mjeteve monetare kontraktuale ashtu dhe duke shitur aktive financiare") ose, nëse asnjë nga (i) dhe (ii) nuk aplikohet, si pjesë e modelit të biznesit "të tjerë" dhe të matur në VDNFH.

Modeli i biznesit përcaktohet për aktivet individuale financiare (në nivel individual) bazuar në të gjitha dëshmitë përkatëse për aktivitetet që Kompania ndërmerr për të arritur objektivin e caktuar për aktivin në dispozicion në datën e vlerësimit. Faktorët që konsiderohen nga kompania në përcaktimin e modelit të biznesit përfshijnë: qëllimin e aktivitetit, përvojën e kaluar në mënyrën se si janë arkëtuar fluksin e mjeteve monetare për aktivet përkatëse, si vlerësohen dhe menaxhohen rreziqet, si vlerësohet performanca e aktiveve dhe si menaxherët kompensohen.

Aktivet financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – karakteristikat e fluskeve monetare. Kur modeli i biznesit është mbajtja e aktiveve për të mbledhur flukse monetare kontraktuale ose për të mbajtur flukse monetare kontraktuale dhe për ti shitur, kompania vlerëson nëse fluksin e mjeteve monetare përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit ("VPPI"). Gjatë marrjes së këtij vlerësimi, kompania konsideron nëse fluksin monetare

4. Politika Kontabël të rëndësishme (vazhdim)

4.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

kontraktuale janë në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, pra interesi përfshin vetëm konsideratën për rrezikun e kredisë, vlerën në kohë të parasë, rreziqet e tjera të huadhënies dhe marzhin e fitimit. Kur kushtet kontraktuale paraqesin ekspozim ndaj rrezikut ose paqëndrueshmërisë që nuk është në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, aktivi financiar klasifikohet dhe matet në VDNFH. Vlerësimi i VPPI kryhet në njohjen fillestare të një aktivi dhe nuk rivlerësohet më pas. Referojuni Shënimit 2.5 për gjykimet kritike të aplikuara nga Kompania në kryerjen e provës VPPI për asetet e saj financiare.

Aktivitet financiar – pakësimi i vlerës. Shoqëria do të pakësojë vlerën bruto të mbartur të një aktivi financiar kur njësia ekonomike në mënyrë të arsyeshme nuk pret të rikuperojë vlerën e plotë apo një pjesë të këtij aktivi financiar. Pakësimi i vlerës përfaqëson një ngjarje çregjistrimi. Treguesit që nuk ka parashikime të arsyeshme të rimëkëmbjes përfshijnë shkelje të kushteve të kontratës si vonesa në pagesa ose ngjarje të mos pagesës në kohë, paaftësi paguese dhe falimentim. Kompania mund të çvlerësojë aktivitet financiar që ende i nënshtrohen veprimtarisë së zbatimit kur Shoqëria kërkon të rimarrë shumat që janë për pjesë e kontratës, megjithatë, nuk ka shpresa të arsyeshme për rimarrje.

Aktivitet financiar - çregjistrimi. Shoqëria çregjistron aktivitet financiar kur (a) përfundojnë të drejtat kontraktuale për flukset monetare nga aktivi financiar ose (b) kompania ka transferuar të drejtat për flukset e mjeteve monetare nga aktivitet financiar ose kanë hyrë në një marrëveshje ku ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar (“aktivi fillestar”), por merr përsipër një detyrim kontraktual për t’ua paguar këto flukse të mjeteve monetare një ose më shumë njësive ekonomike pra kur (i) transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të aktivitet financiar, ose (ii) nuk ka ruajtur kontrollin dhe as nuk transferon, as nuk mban thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivitet financiar. Kontrolli ruhet në qoftë se pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për të shitur asetin në tërësi tek një palë e tretë e palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë për shitjen.

Detyrimet financiare – kategorite e matjes. Detyrimet financiare klasifikohen si të matura më pas me Koston e Amortizuar (KA), përveç (i) detyrimeve financiare të matur me VDNFH. Ky klasifikim zbatohet për derivativët, detyrimet financiare të mbajtura për tregtim (p.sh. pozicionet e shkurtra në letra me vlerë), shumës së kushtëzuar të njohur nga një blerës në një kombinim biznesi dhe detyrime të tjera financiare të përcaktuara si të tilla në njohjen fillestare dhe (ii) kontratat e garancisë financiare dhe angazhimet e huasë.

Detyrimet financiare – çregjistrimi. Detyrimet financiare çregjistrohen kur ato shuhet (dmth. Kur detyrimi i specifikuar në kontratë shlyhet, anulohet ose përfundon).

Kompensimi i instrumenteve financiare. Aktivitet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe raportohet shuma neto në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për kompensimin e shumave të njohura dhe ka një qëllim që të shlyhet në baza neto ose të realizojë aktivin dhe zgjidhë detyrimin në të njëjtën kohë. Kjo e drejtë e kompensimit (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjrisht e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast vonese të pagesave dhe (iii) në rast të paaftësisë së pagesës ose falimentimit.

Instrumentat financiarë jo – derivativë

Shoqëria zotëron vetëm instrumente financiare jo-derivative, të përbërë nga llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe llogari të tjera, mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, llogaritë e pagueshme tregtare dhe llogari të tjera, kreditë e tjera. Të gjitha instrumentet financiare fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Pas njohjes fillestare, instrumentet financiare të shoqërisë maten me koston e amortizuar.

Vlera e drejtë është shuma në të cilën një instrument financiar mund të këmbëhet në një transaksion të tanishëm midis palëve të gatshme, përveçse në një shitje të detyruar ose likuidim, dhe dëshmohet më së miri nga një çmim aktiv i kuotuar i tregut. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare që nuk tregtohen në një treg aktiv (asnjë nga aktivitet financiar të Shoqërisë nuk tregtohet në një treg aktiv) përcaktohet duke përdorur teknikat e vlerësimit.

(Vlerat janë në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

4. Politika Kontabël të rëndësishme (vazhdim)

4.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Në njohjen fillestare, vlera e drejtë e të gjitha aktiveve financiare vlerësohet të përafrohet me koston e tyre të transaksionit.

Kosto e amortizuar është shuma në të cilën instrumenti financiar është njohur në momentin fillestar minus çdo ripagim të principalit, plus interesin e përlogaritur, dhe minus çdo kompensim për humbjet e pritura të kredisë për aktivet financiare.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat të cilat janë subjekt i rrezikut të parëndësishëm të ndryshimeve në vlerën e tyre të drejtë dhe përdoren nga Shoqëria në menaxhimin e angazhimeve afatshkurtra të saj. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit. Mjetet monetare të kufizuara me një afat maturimi mbi 12 muaj klasifikohen si aktive të tjera afatgjata.

Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera

Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera janë aktive financiare me pagesa fikse apo të përcaktueshme të cilat nuk janë të kuotuar në një treg aktiv. Aktive të tilla njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot të lidhura direkt me transaksionin. Pas njohjes fillestare llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera maten me koston e amortizuar pakësuar me humbjet nga zhvlerësimi.

Detyrimet financiare jo - derivative

Shoqëria fillimisht i njeh detyrimet financiare në datën e tregtimit, kur shoqëria bëhet palë e kushteve kontraktuale të instrumentit. Shoqëria e çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet e tij kontraktuale shlyhen ose anulohen apo përfundojnë.

Aktivitet dhe detyrimet financiare netohen dhe paraqiten me vlerë neto në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Shoqëria ka një të drejtë ligjore për të netuar shumat e tyre, dhe ka për qëllim ose të shlyejë shumën neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Detyrimet financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kosto të lidhura direkt me transaksionin.

Pas njohjes fillestare këto detyrime maten me koston e amortizuar.

4.3 Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me, paraqiten me vlerën më të ulët mes koston dhe vlerës së realizueshme neto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Vlera e realizueshme neto është çmimi i shitjes i përlogaritur gjatë rrjedhës normale të biznesit minus kostot e përlogaritura për përfundimin dhe realizimin e shitjeve.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

4.4 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

4. Politika Kontabël të rëndësishme (vazhdim)**4.4 Aktive afatgjata materiale (vazhdim)**

Për të përcaktuar nëse një aktiv që ka në përbërjen e tij si elemente materiale ashtu dhe jomateriale, duhet të trajtohet sipas SNK 16 - Aktivitet Afatgjata Materiale apo sipas SNK 38 - Aktive afatgjata jomateriale, manaxhimi përdor gjykimin për të përcaktuar se cili element është më i rëndësishëm, në mënyrë që të rregjistrojë aktivin siç duhet. Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitet afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitet.

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi dhe ndryshohen në rast se efektet janë materiale.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2022 dhe 2021 është si më poshtë:

| Kategoria e aktiveve | Metoda e Amortizimit | Norma e Amortizimit | |
|-----------------------------|----------------------|---------------------|------|
| | | 2022 | 2021 |
| Ndërtesa | Vlera e mbetur | 5% | 5% |
| Makineri dhe pajisje | Vlera e mbetur | 20% | 20% |
| Instalime Teknike specifike | Vlera e mbetur | 20% | 20% |
| Mobilje dhe orendi | Vlera e mbetur | 20% | 20% |
| Mjete transporti | Vlera e mbetur | 20% | 20% |
| Pajisje informatike | Vlera e mbetur | 25% | 25% |
| Të tjera | Vlera e mbetur | 20% | 20% |

Vlera e mbartur e aktiveve afatgjata materiale rishikohen për zhvlerësim kur ngjarje apo ndryshime në rrethanat tregojnë se vlera kontabël mund të mos jetë e rikuperueshme. Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë, kur vlera kontabël tejkalon vlerën e rikuperueshme të vlerësuar aktivitet paraqiten me vlerën e tyre të rikuperueshme, e cila është më e larta mes vlerës së tyre të drejtë minus kostot për shitje dhe vlerës së tyre në përdorim.

Amortizimi nuk aplikohet për tokën dhe punimet në proces që nuk janë në funksionim.

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

4.5 Aktivitet Afatgjata Jomateriale

Një aktiv jo-material njihet nëqoftëse, e vetëm nëqoftëse është e mundshme që përfitimet e pritshme ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij aktivitet do të rrjedhin tek njësi ekonomike; dhe kosto e aktivitet mund të matet me besueshmëri.

Një njësi ekonomike vlerëson mundësinë e përfitimeve të pritshme ekonomike në të ardhmen duke përdorur supozime të arsyeshme dhe të mbështetura që përfaqësojnë vlerësimin më të mirë të drejtimit të kompletit të kushteve ekonomike që do të ekzistojnë gjatë jetës së dobishme të aktivitet.

(Vlerat janë në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

4. Politika Kontabël të rëndësishme (vazhdim)

4.5 Aktivet Afatgjata Jomateriale (vazhdim)

Njësia ekonomike përdor gjykimin për të vlerësuar shkallën e sigurisë bashkëngjitur flukseve të përfitimeve ekonomike në të ardhmen që i atribuohen përdorimit të aktivitetit mbi bazën e evidencës së disponueshme në kohën e njohjes fillestare, duke i dhënë më shumë rëndësi evidencës nga të tretët.

Një aktiv jo-material matet fillimisht me kosto.

Mbajtja e mëpasshme

Mbas njohjes fillestare, një aktiv jo-material mbartet me koston e tij minus çdo amortizim të akumuluar dhe çdo humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

4.6. Aktive në përdorim

Shoqëria njihet të drejtën e përdorimit të një aktivi dhe një detyrim qiraje në datën e fillimit të qirasë. Aktivi me të drejtën e përdorimit fillimisht matet me kosto, i cili përfshin shumën fillestare të detyrimit të qirasë të rregulluar për çdo pagesë qiraje të bërë në ose para datës së fillimit, plus çdo shpenzim fillestar të drejtpërdrejtë të kryer dhe një vlerësim të kostove për çmontimin dhe largimin ose rivendosjen e aktivitetit ose zonës së vendndodhjes në të cilën është, duke zbritur çdo përfitim të marrë. Aktivi me të drejtë përdorimi amortizohet më pas duke përdorur metodën lineare nga data e fillimit deri në fund të jetës së dobishme të aktivitetit ose në fund të afatit të qirasë financiare.

4.7. Aktive jo financiare

Vlerat kontabël të aktiveve jofinanciare të Shoqërisë janë rishikuar në datën e raportimit për të përcaktuar në qoftë se ka ndonjë tregues zhvlerësimi. Në qoftë se ndonjë tregues i tillë ekziston, atëherë llogaritet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Shuma e rikuperueshme është vlera më e lartë midis vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e vlerësuarat monetare të ardhshme janë zbritur për vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike për aktivin për të cilat vlerësimet e flukseve monetare të ardhshme nuk janë rregulluar.

Humbjet nga zhvlerësimi njihen në qoftë se vlera e mbartur e aktivitetit apo pjesa e burimit të parave e kalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi janë njohur në të ardhura ose shpenzime.

4.8. Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale.

4.9. Dividendët

Shpërndarja e dividendëve (fitimeve) për pronaret njihet në pasqyrat financiare të shoqërisë si detyrim në periudhën në të cilën janë aprovuar nga pronaret e Shoqërisë.

4.10. Të ardhurat

Të ardhurat njihen kur kontrolli i një malli ose shërbimi transferohet tek një klient. Të ardhurat njihen në bazë të shumës së specifikuar së kontratës me klientin dhe përjashton shumën e mbledhura për interesat e palëve të treta. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasinë (volumin) e blerë.

Shoqëria fiton shumicën e të ardhurave të saj nga shitja e mallrave (materiale ndertimi, objekte ndertimi) dhe shitjes së shërbimeve (punime ndertimi).

4. Politika Kontabël të rëndësishme (vazhdim)

4.10. Qiratë

Në fillim të një kontrate, Shoqëria vlerëson nëse një kontratë është ose përmban një kontratë qiraje financiare. Një kontratë është ose përmban një kontratë qiraje financiare nëse kontrata përcakton të drejtën për të kontrolluar përdorimin e një aktivi të identifikuar për një periudhë kohe në këmbim të një përfitimi të marrë.

Për të vlerësuar nëse një kontratë përcakton të drejtën për të kontrolluar përdorimin e një aktivi të identifikuar, Shoqëria vlerëson nëse:

- kontrata përfshin përdorimin e një aktivi të identifikuar - kjo mund të specifikohet në mënyrë eksplicite ose implicite dhe duhet të jetë fizikisht e dallueshme ose të përfaqësojë në thelb të gjithë kapacitetin e një pasurie fizikisht të dallueshme. Nëse furnizuesi ka një të drejtë zëvendësimi substancial, atëherë asetit nuk identifikohet;
- Shoqëria ka të drejtë të përfitojë në mënyrë të konsiderueshme të gjitha përfitimet ekonomike nga përdorimi i aktivitetit gjatë gjithë periudhës së përdorimit; dhe
- Shoqëria ka të drejtën të drejtojë përdorimin e aktivitetit. Shoqëria ka këtë të drejtë kur ka të drejtat e vendimmarrjes që janë më të rëndësishme për të ndryshuar mënyrën dhe për çfarë qëllimi përdoret aktivi.

4.11. Grantet

Grantet që lidhen me aktivitetet, përfshirë grantet jo monetare me vlerë të drejtë, paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar duke e njohur grantin si të ardhur të shtyrë, e cila njihet si e ardhur në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera të përgjithshme në mënyrë sistematike dhe proporcionale përgjatë jetës së dobishme të aktivitetit.

4.12. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

4.13. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital. Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2022 është 6.2% (2021: 5.8%).

4. Politika Kontabël të rëndësishme (vazhdim)

4.14. Tatimi mbi fitimin (vazhdim)

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet për humbjet e papërdorura tatimore dhe diferencat e përkohshme të zbritshme për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit të mund të përdoren. Fitimet e ardhshme të tatueshme përcaktohen bazuar në anulimin e diferencave përkatëse të përkohshme të tatimit. Nëse shuma e diferencave të përkohshme është e pamjaftueshme për të njohur një aktiv tatim të shtyrë të plotë, atëherë fitime të ardhshme të tatueshme, të rregulluar me anulimet e diferencave ekzistuese të përkohshme, konsiderohen, bazuar në planin e biznesit. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe reduktohen në masën që nuk është më e mundur që përfitimi tatimor i lidhur me to të realizohet; të tilla reduktime anulohen kur probabiliteti i fitimeve të ardhshme të tatueshme përmirësohet. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe njihen në masën që është e mundur që fitime të ardhshme të tatueshme mund të ekzistojnë ndaj të cilave mund të përdoret.

Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

4.15. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

4.16. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

4.17. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

4.18. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4.19. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Kur është e nevojshme, shifrat krahasuese axhustohen (rregullohen) në konform me ndryshimet në paraqitje në periudhën aktuale raportuese. Ndryshimet janë kryer për të paraqitur më mirë natyrën e biznesit të Shoqërisë. Ato aplikohen retrospektivisht. Ndryshimet përfshijnë riklasifikime brenda zërave të seksionit të aktiveve dhe pasiveve në pasqyrën pozicionit financiar si edhe në pasqyrën të fitim humbjes.

5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale.

Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë

5.1 Jeta e dobishme e aktiveve

Përcaktimi i jetës së dobishme të aktiveve bazohet në përvojën historike me asete të ngjashme si dhe çdo zhvillim teknologjik të parashikuar dhe ndryshimet në faktorët ekonomikë e industrialë. Përshtatshmëria e vlerësimeve të jetës së dobishme të aktiveve rishikohet çdo vit, ose në çdo kohë kur ka një tregues për ndryshime të rëndësishme në supozimet themelore. Ky është një vlerësim kontabël kritik për shkak se përfshin supozime mbi zhvillimet teknologjike, në një degë shumë inovative si telekomunikacioni.

5.2 Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme – Humbjet e pritshme të kredise

Vlerësimi i modelit të biznesit

Modeli i biznesit orienton klasifikimin e aktiveve financiare. Gjatë vlerësimit të transaksioneve të shitjes, Kompania konsideron frekuencën, kohën dhe vlerën e tyre historike, arsyet për shitjet dhe pritjet për aktivitetin e shitjeve të ardhshme. Transaksionet e shitjeve që kanë për qëllim minimizimin e humbjeve të mundshme për shkak të rrezikut të kredisë mund të jetë në përputhje me modelin e biznesit objektivi i të cilit është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale. Shitjet e tjera para maturimit, jo të lidhura me aktivitetet e administrimit të rrezikut të kredisë, janë gjithashtu në përputhje me modelin e biznesit objektivi i të cilit është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale, me kusht që ato të jenë të rralla ose të parëndësishme në vlerë, si individualisht dhe në tërësi.

Kompania vlerëson rëndësinë e transaksioneve të shitjes që nga fillimi i aktivitetit të saj të shitjes. Modeli i biznesit "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale dhe për të shitur" nënkupton që mjetet janë mbajtur për të mbledhur flukset e mjeteve monetare, por shitja është gjithashtu pjesë integrale për arritjen e objektivit të modelit të biznesit, siç janë menaxhimi i nevojave të likuiditetit, arritja e një kthimi të caktuar ose përputhja e kohëzgjatjes së aseteve financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që financojnë këto asete.

Gjatë aplikimit në SNRF 9, kompania identifikoi se:

- Rreziqet kryesore të modelit të biznesit janë në përputhje me modelin "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale" me fokus në rrezikun e kredisë. Asnjë peshë nuk jepet për çmimin ose rrezikun e vlerës së drejtë;
- Deri më tani nuk ka pasur asnjë shitje të aktivitetit financiar. Shitjet do të ndodhin vetëm në përgjigje të përkeqësimit të rrezikut të kredisë nga pala tjetër, që rezulton nga shkeljet e kritereve të brendshme të rrezikut të kredisë. Këto shitje do të ishin në përputhje me modelin "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale". Një shitje për shkak të plotësimit të nevojave të likuiditetit do të ishte rastësore. Prandaj, modeli i biznesit që lidhet me Llogaritë e Arkëtueshme konsiderohet të jetë "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale".

Vlerësimi nëse flukset e mjeteve monetare janë vetëm pagesa principali dhe interesit ("VPPI")

Përcaktimi nëse flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar janë vetëm pagesa principali dhe interesit kërkon gjykim.

Të arkëtueshmet tregtare të Shoqërisë përfshijnë një fluks të vetëm të parasë, pagesën e shumës që rezultojnë nga një transaksion në fushën e zbatimit të SNRF 15, që konsiderohet të jetë principali. Rrjedhimisht, flukset monetare që rrjedhin nga të arkëtueshmet plotësojnë testin VPPI të pagesave të principalit dhe interesit pavarësisht se përbërësi i interesit është zero.

5. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)

5.2 Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme – Humbjet e pritshme te kredise (vazhdim)

Matjet e humbjeve të parashikuara të kredisë

Niveli i humbjeve nga zhvlerësimi llogaritet për llogaritë e arkëtueshme të matura me koston e amortizuar. Meqenëse të arkëtueshmet tregtare nuk përmbajnë një komponent të rëndësishëm financimi, niveli i humbjeve do të llogaritet bazuar në humbjet e pritshme të kreditit. Aplikimi i SNRF 9 nuk rezulton në një vlerë materiale, prandaj Shoqëria nuk ka kontabilizuar Humbje të parashikuara të kredise për aktivet financiare.

5.3 Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

5.4 Zhvlerësimi i inventarëve

Shoqëria vlerëson gjendjen e inventarit në qarkullim të ulët dhe inventarin i cili ka humbur vlerën e përdorimit për shkak të zhvillimeve teknologjike apo arsyeve të tjera, me synim për të përcaktuar masën e zhvlerësimit të inventarit, bazuar në përdorimin e ardhshëm të tij dhe në llogaritjen e vlerës neto të realizueshme. Në rast se vlera neto e realizueshme e inventarit është më e ulët se vlera kontabël neto, ekziston një tregues që inventari është i zhvlerësuar. Shoqëria përdor gjykimin e saj për të përcaktuar masën e zhvlerësimit.

6 Aktivet afatgjata materiale

Gjendja e Aktiveve te Qendrueshme ne date 31.12.2022

| Emertimi | Toka ,terrene, troje | Ndertime dhe instalime te pergj | Instalime teknike Makineri Pajisje | Mjete transporti | Pajisje zyre dhe informatike | Totali |
|------------------------------|-----------------------|---------------------------------|------------------------------------|-----------------------|------------------------------|-----------------------|
| <i>Aktive te Trupëzuara</i> | | | | | | |
| Gjendje 01.01.2022 | 397,293,926.00 | 260,869,173.00 | 69,377,115.00 | 150,641,126.00 | 7,025,488.00 | 885,206,828.00 |
| Shtesa | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 38,209,960.00 | 0.00 | 38,209,960.00 |
| Pakesime | 32,904,743.00 | 3,789,636.00 | 8,074,566.00 | 200,000.00 | 0.00 | 44,968,945.00 |
| Gjendje 31.12.2022 | 364,389,183.00 | 257,079,537.00 | 61,302,549.00 | 188,651,086.00 | 7,025,488.00 | 878,447,843.00 |
| <i>Amortizimi</i> | | | | | | |
| Gjendje ne 01.01.2022 | 0.00 | 25,100,644.00 | 61,183,620.00 | 121,185,392.00 | 3,297,450.00 | 210,767,106.00 |
| Shtesa llogaritur | 0.00 | 2,882,064.00 | 1,631,160.00 | 10,376,952.00 | 722,494.00 | 15,612,670.00 |
| Pakesime | 0.00 | 634,855.00 | 7,711,902.00 | 193,133.00 | 0.00 | 8,539,890.00 |
| Gjendje ne 31.12.2022 | 0.00 | 27,347,853.00 | 55,102,878.00 | 131,369,211.00 | 4,019,944.00 | 217,839,886.00 |
| <i>Vlera neto 01.01.2016</i> | <i>397,293,926.00</i> | <i>235,768,529.00</i> | <i>8,193,495.00</i> | <i>29,455,734.00</i> | <i>3,728,038.00</i> | <i>674,439,722.00</i> |
| <i>Vlera neto 31.12.2016</i> | <i>364,389,183.00</i> | <i>229,731,684.00</i> | <i>6,199,671.00</i> | <i>57,281,875.00</i> | <i>3,005,544.00</i> | <i>660,607,957.00</i> |

ADMINISTRATORI

Luan LARTI

LARTI SH.P.K**Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2022***(Vlerat janë në Lek)***7. Inventari**

Balanca e inventarit të shoqërisë më 31 Dhjetor 2021 dhe 31 Dhjetor 2022 paraqitet si më poshtë:

| Inventare | 31 Dhjetor 2022 | 31 Dhjetor 2021 |
|---|------------------------|------------------------|
| <i>Lende e pare dhe materiale te konsumueshme</i> | 89,322,962 | 56,345,411 |
| <i>Mallra</i> | 187,425,758 | 197,871,142 |
| <i>AAGJM te mbajtura per shitje</i> | 301,177,850 | 435,316,094 |
| <i>Parapagime per inventar</i> | 41,020,777 | 86,987,479 |
| | 618,947,347 | 776,520,126 |

8. Llogari të arkëtueshme tregtare

Gjendja e llogarive të arkëtueshme tregtare më 31 Dhjetor 2021 dhe 31 Dhjetor 2020 detajohet si më poshtë:

| | <u>31 dhjetor 2022</u> | <u>31 dhjetor 2021</u> |
|-----------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Kliente te paarketuar | 1,520,653,346 | 883,699,144 |
| | <u>1,520,653,346</u> | <u>883,699,144</u> |

9. Llogari të arkëtueshme të tjera afatshkurtra

Llogaritë e arkëtueshme të tjera afatshkurtra të Shoqërisë më 31 Dhjetor 2021 dhe 31 Dhjetor 2020 detajohen si më poshtë:

Ne daten 31.Dhjetor 2022 ka nje vlere prej 3,916,664 leke , kundrejt vleres 1,725,087 qe kishte ne 31 Dhjetor 2021, dhe perfaqeson kerkesa nga dogana.

10. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra më 31 Dhjetor 2021 dhe 31 Dhjetor 2020 paraqitet si më poshtë:

| | <u>31 dhjetor 2022</u> | <u>31 dhjetor 2021</u> |
|---|-------------------------------|-------------------------------|
| Fatura per parafagime per blerje | 308,636 | 107,141 |
| Shpenzime te periudhave te ardhshme (Ndertime ne proces situacionet e punimeve) | 429,997,241 | 273,455,378 |
| | <u>430,305,877</u> | <u>273,562,524</u> |

11. Mjete monetare

Balancat e mjeteve monetare më 31 Dhjetor 2022 dhe 31 Dhjetor 2021 paraqiten si në vijim:

| | <u>31 dhjetor 2022</u> | <u>31 dhjetor 2021</u> |
|-------------------------|------------------------|------------------------|
| Mjete monetare në bankë | 234,542,143 | 459,171,457 |
| Mjete monetare në arkë | 942,186 | 49,800,337 |
| Likuiditete në udhëtim | 0 | 53,451,751 |
| | <u>235,484,329</u> | <u>562,423,545</u> |

16. Kapitali

Kapitali i shoqërisë më 31 dhjetor 2022 është në vlerën 960,000,000 Lekë, i cili zotërohet nga PRONARET e shoqërisë.

Rezervat ligjore të shoqërisë më 31 dhjetor 2022 janë në vlerën 94,415,664 Lekë, njësoj si edhe vitin e kaluar. Fitimet e mbartura më 31 Dhjetor 2022 janë në vlerën 294,098,223 Lekë. Nga fitimet e vitit të kaluar janë shperndare si dividend vlera prej 20,000,000 leke.

17. Huatë afatgjata dhe afatshkurtra

Huatë afatgjata më 31 dhjetor 2022 dhe 31 Dhjetor 2021 përfaqësojnë vlerën e marrë të huave në bankë dhe paraqiten si më poshtë.

| | <u>31 dhjetor 2021</u> | <u>31 dhjetor 2020</u> |
|---|------------------------|------------------------|
| Pjesa afatgjatë e huasë – Pro Credit Bank | 57,097,354 | 60,334,147 |
| | <u>57,097,354</u> | <u>60,334,147</u> |

Huatë afatshkurtra më 31 Dhjetor 2022 dhe 31 Dhjetor 2021 detajohen si më poshtë:

| | <u>31 dhjetor 2022</u> | <u>31 dhjetor 2021</u> |
|---------------------------|------------------------|------------------------|
| Overdraft Pro Credit Bank | 48,319,290 | 244,458,432 |
| | <u>48,319,290</u> | <u>244,458,432</u> |

18. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 Dhjetor 2021 dhe 31 Dhjetor 2020 detajohen si më poshtë:

| | <u>31 dhjetor 2022</u> | <u>31 dhjetor 2021</u> |
|--------------------|------------------------|------------------------|
| Furnitore detyrime | 641,513,421 | 381,201,321 |
| | <u>1,401,767,724</u> | <u>1,594,601,845</u> |

19. Detyrimet tatimore dhe detyrime ndaj punonjesve

Detyrimet tatimore të Shoqërisë më 31 Dhjetor 2022 dhe 31 Dhjetor 2021 detajohen si më poshtë:

| | <u>31 dhjetor 2022</u> | <u>31 dhjetor 2021</u> |
|----------------------------------|------------------------|------------------------|
| Detyrime për tatimin mbi fitimin | 140,334 | 2,597,897 |
| TVSH për t'u paguar | 15,637,853 | 3,476,512 |
| | <u>15,778,187</u> | <u>6,074,409</u> |

| | <u>31 dhjetor 2022</u> | <u>31 dhjetor 2021</u> |
|--|------------------------|------------------------|
| Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore | 791,209 | 897,130 |
| Detyrime per paga | 2,686,467 | 2,521,659 |
| | <u>3,477,676</u> | <u>3,418,789</u> |

20. Grante, të ardhura të shtyra dhe të tjera detyrime afatshkurtra

Grantet, të ardhurat e shtyra dhe të tjera detyrime afatshkurtra të Shoqërisë më 31 Dhjetor 2021 dhe 31 Dhjetor 2020 detajohen si më poshtë:

| | <u>31 dhjetor 2022</u> | <u>31 dhjetor 2021</u> |
|----------------------|------------------------|------------------------|
| Të ardhura të shtyra | 225,640,628 | 313,753,211 |
| | 225,640,628 | 313,753,211 |

Te ardhurat e shtyra jane paraqitur faturat e shitjes per paradhenjet e arketuara nga klientet .

21. Llogari të tjera të pagueshme

Llogari të tjera të pagueshme më 31 Dhjetor 2021 dhe 31 Dhjetor 2020 përbëhen si më poshtë:

| | <u>31 dhjetor 2021</u> | <u>31 dhjetor 2020</u> |
|-------------------------|------------------------|------------------------|
| Dividend për t'u paguar | 122,095,974 | 112,172,554 |
| | 122,095,974 | 112,172,554 |

22. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit për periudhën e mbyllur 31 Dhjetor 2022 dhe 31 Dhjetor 2021 detajohen si më poshtë:

| | <u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022</u> | <u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</u> |
|---------------------------------------|---|---|
| Të ardhura nga shitja e mallrave | 5,726,215,989 | 6,011,371,905 |
| Të ardhura nga shitje punime ndertimi | 383,275,798 | 294,683,717 |
| Të ardhura nga transport per te trete | 32,493,037 | 23,052,964 |
| Të ardhura nga qera | 12,894,195 | 9,968,262 |
| | 6,154,879,019 | 6,339,076,848 |

23. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit (vazhdim)**Rakordimi I të ardhurave me FDP**

| | <u>31 Dhjetor 2022</u> |
|---|------------------------|
| Qarkullim i tatueshëm sipas FDP | 6,066,766,436 |
| Ndryshimi në parapagimet (shtohet ulja e parapagimi ne fund te vitit krahasuar me celjen)te ardhura te shtyra | 88,112,583 |
| Shuma e qarkullimit e korrektuar | 6,154,879,019 |
| Sipas Kontabilitetit | 6,154,879,019 |
| Diferenca | - |

24. Materiale dhe shërbime direkte

Shpenzimet për materiale dhe shërbime direkte për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2021 detajohen si më poshtë:

| | <u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</u> |
|-------------------------------|--|
| Mallra | 5,189,749,672 |
| Mallra dhe materiale të tjera | 134,385,081 |
| Lende djegese , karburant | 175,533,310 |
| Pjese ndërrimi | 24,088,971 |
| Energji | 2,034,246 |
| Te tjera | 25,842 |
| VI kontabel e AQ te shitura | 3,524,311 |
| | <u>5,529,341,432</u> |

25. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2022 dhe 31 Dhjetor 2021 detajohen si më poshtë:

| | <u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022</u> | <u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</u> |
|---|--|--|
| Shpenzime për paga | 32,677,193 | 32,377,589 |
| Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore | 5,456,701 | 5,407,059 |
| | <u>38,133,894</u> | <u>37,784,648</u> |

26. Shpenzime amortizimi

Shpenzimet e amortizimit për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2022 dhe 31 Dhjetor 2021 detajohen si më poshtë:

| | <u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022</u> | <u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</u> |
|---|--|--|
| Shpenzime amortizimi Aktive afatgjata materiale | 15,612,670 | 12,775,406 |
| | <u>15,612,670</u> | <u>12,775,406</u> |

27. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzime të tjera të shfrytëzimit për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2022 dhe 31 Dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

| | <u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022</u> | <u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</u> |
|---|--|--|
| Mirëmbajtje dhe riparime | 18,392,049.79 | 1,235,159 |
| Sigurime | 9,259,223.45 | 10,411,172 |
| Të tjera | 6,446,450.32 | 4,698,417 |
| dioda | 3,038,082.70 | 13,645,461 |
| Personel jashtë njesisë | 1,092,283.33 | 51,106,827 |
| punime me te trete pallati 5-6 (8kate 2020) | 10,480,538.00 | 0 |
| punime me te trete pallati 7-8 (viti 2021) | 23,868,919.70 | 0 |
| punime me te trete pallati 8-9 (viti 2022) | 12,916,775.83 | 0 |
| punime me te trete pallati 10-11-12 (viti 2022) | 1,543,266.00 | 0 |
| agjensi doganore ne shqiperi | 11,763,321.29 | 0 |
| agjensi doganore greqi | 3,340,248.00 | 0 |
| Transferime, udhëtime, dieta | 6,512,449.00 | 7,356,829 |
| Shpenzime postare dhe telekomunikimi | 1,690,532.98 | 1,235,301 |
| Shpenzime transpoti | 65,400.00 | 10,292,340 |
| Për personelin | 49,200.00 | 0 |
| Shpenzime për shërbimet bankare | 1,655,156.97 | 2,067,294 |
| Taksa, tarifa doganore | 351,936.00 | 317,468 |
| Akciza | 114,509.00 | 238,060 |
| Taksa dhe tarifa vendore | 8,912,794.02 | 9,231,404 |
| Taksa e regjistrimit | 2,208,811.67 | 1,738,338 |
| Tatime të tjera | 2,328,723.00 | 4,216,103 |
| Gjoha dhe dëmshpërblime | 1,284,963.21 | 2,160,696 |
| | <u>127,315,634</u> | <u>119,950,869</u> |

28. Shpenzime të tjera financiare (neto)

Shpenzimet e tjera financiare (neto) për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2022 dhe 31 Dhjetor 2021 detajohen si më poshtë:

| | <u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022</u> | <u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</u> |
|----------------------------------|--|--|
| Humbje nga kembimet valutote | (102,092,593) | (23,136,495) |
| Te ardhura nga kembimet valutore | 31,260,108 | 4,799,724 |

(Vlerat janë në Lek)

| | | |
|--------------------------------|---------------------|---------------------|
| Te ardhura te tjera financiare | 8,978,800 | (1,814,039) |
| | (61,853,686) | (20,150,810) |

29. Tatimi mbi fitimin

Përlllogaritja e tatimit mbi fitimin për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqitet si më poshtë:

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 |
|---|---|---|
| Fitimi para tatimit | 382,621,703 | 369,908,620 |
| Fitimi para tatimit total | 382,621,703 | 369,908,620 |
| Shpenzime te panjohura (si me poshtë) | 1,284,963 | 2,160,696 |
| Penalitet, gjoba e demshperblime | 1,284,963 | 2,160,696 |
| Te ardhura të patatueshme | - | - |
| Fitimi para tatimit (përfshire shpenzimet e panjohura) | 383,906,666 | 372,069,316 |
| <i>Tatim fitimi @15%</i> | (57,586,000) | (55,810,397) |
| Tatim Fitimi i parapaguar | 57,445,666 | 53,212,500 |
| Detyrimi per tu paguar | 140,334 | 2,597,897 |

30. Manaxhimi i riskut financiar

Detyrimet financiare kryesore të Shoqërisë përbëhen nga llogaritë e pagueshme dhe të tjera detyrime. Qëllimi kryesor i këtyre detyrimeve financiare është të financojnë operacionet e Shoqërisë dhe të sigurojnë garanci për mbështetjen e operacioneve. Shoqëria ka hua dhe llogari të arkëtueshme, mjete monetare dhe depozita afatshkurtra që sigurohen drejtpërdrejtë nga operacionet e saj. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të tregut, riskut të kreditit dhe riskut të likuiditetit. Manaxhimi i lartë i Shoqërisë mbikqyr manaxhimin e këtyre risqeve.

Risku i tregut

Risku i tregut është risku që vlera e drejtë e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në çmimet e tregut. Çmimet e tregut përfshijnë katër lloje risqesh: risku i normës së interesit, risku i kursit të këmbimit, risku i çmimit të mallrave dhe risqe të tjera të çmimeve, të tilla si risku i çmimit të kapitalit. Instrumentat financiar të prekur nga risku i tregut përfshijnë huatë, kreditë dhe depozitat.

Risku i normave të interesit

Risku i normës së interesit përbëhet nga risku që vlera e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në normat e interesit në treg dhe riskut që maturitetet e aktiveve që mbartin interes të ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve që mbartin interes të përdorura për të financuar ato aktive. Zgjatja kohore përgjatë të cilës norma e interesit e një instrumenti financiar është fikse, përcakton se në çfarë mase është e ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit.

Aktivitet dhe detyrimet e Shoqërisë nuk mbartin risk të normave të interesit.

Risku i kreditit

Risku i kreditit është risku që një palë tjetër nuk do të jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj që rrjedhin nga një instrument financiar ose marrëveshje klienti, duke çuar kështu në një humbje financiare. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të kreditit për shkak të aktiviteteve operacionale të saj (pikë së pari prej llogarive të arkëtueshme) dhe prej aktiviteteve të saj financuese, që përfshijnë depozitat me bankat dhe institucionet financiare, transaksionet në monedha të huaja dhe instrumenta të tjerë financiare.

Risku i kreditit është i kufizuar në vlerën kontabël të aktiveve financiare në datën e raportimit.

31. Manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

Risku i likuiditetit (vazhdim)

Risku i likuiditetit është risku që Shoqëria mund të mos jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj të lidhura me detyrimet financiare në momentin e pagesës. Risku i likuiditetit është risk i qenësishëm në biznesin e Shoqërisë pasi disa aktive specifike të blera apo detyrime të shitura mund të kenë karakteristika likuiditeti që janë specifike. Nëse Shoqërisë do ti duhet të ketë shuma të mëdha në një afat të shkurtër kohor që tejkalon kërkesat normale për mjete monetare mundet që të ndeshet me vështirësi për të siguruar çmime konkurruese. Shoqëria manaxhon riskun e likuiditetit duke monitoruar në mënyrë të vazhdueshme parashikimet dhe flukset monetare aktuale dhe duke u munduar të përputhë profilet e maturitetit të aktiveve dhe detyrimeve.

32. Manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

Risku i monedhës

Shoqëria ndërmerr transaksione në monedhë të huaj si pasojë e ekspozimit ndaj luhatjeve të kurseve të këmbimit. Ekspozimi ndaj kurseve të këmbimit manaxhohet duke përcaktuar një politikë midis të arkëtueshmeve dhe të pagueshmeve. Vlera kontabël neto e aktiveve dhe detyrimeve monetare të shoqërisë sipas monedhave për vitin që u mbyll janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

33. Vlera e drejtë e instrumentave financiare

Instrumentat financiarë përfshijnë aktivet dhe detyrimet financiare.

Aktivët financiarë përbëhen nga gjendja e llogarive në bankë dhe të arkëtueshmet. Detyrimet financiare përbëhen nga të pagueshmet.

Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare përfshihet në shumën në të cilën instrumenti mund të shkëmbëhet në një transaksion mes palëve të gatshme, dhe jo të detyrueshme të në një proces likuidimi ose shitje. Vlerat e drejta të të gjitha aktiveve financiare të shoqërisë përafrojnë vlerat e tyre kontabël kryesisht për shkak të maturimit afatshkurtër të këtyre instrumentave.

34. Burimet kryesore në vlerësimin e pasigurisë

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Një vlerësim i shumës së mbledhshme të llogarive të arkëtueshme tregtare kryhet kur arkëtimi i shumës së plotë nuk është më e mundur. Për shumat individuale të rëndësishme, ky vlerësim është kryer në baza individuale. Shumat të cilat nuk janë të rëndësishme individualisht, por që janë të vonuara, vlerësohen në mënyrë kolektive dhe aplikohet një provizion në përputhje me kërkesat e SNRF 9 për Humbjet e pritshme të kredise.

35. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në vlerësimin e departamentit ligjor, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2022 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2021 dhe 2020. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

36. Ngjarje pas datës së raportimit financiar

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit të cilat do të kërkonin korrigjim ose shënime në pasqyrat financiare.

HARTUESI
Laureta ÇAÇELLI

ADMINISTRATORI
Luan LARTI